



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1457 Prot.

Vlorë, më 15/05/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të një akti administrativ – Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.50, me Nr.1023/2 Prot., datë 22/04/2025, i materializuar për subjektin “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H, me seli në Vlorë (Lagjja “Dëshmorët”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, ish NPV, Kati II), me administrator z.Hu Yiben.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 5 (pesë) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr.1023/2 Prot.

Vlorë, më 22/04/2025

V E N D I M N r . 5 0

Sot, më datë 22/04/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “**MANIFATTURA ITALIANA II**” sh.p.k me NUIS M36801201H, me seli në Vlorë (Lagjja “Dëshmorët”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, ish NPV, Kati II), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032749, nr.1023 Prot., datë 04/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjislacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “**MANIFATTURA ITALIANA II**” sh.p.k me NUIS M36801201H, është mbajtur konstatimi si vijon : *Operatori ekonomik “Manifattura Italiana II” Shpk me NIPT M36801201H, që vepron nën regjimin e përpunimit aktiv sipas autorizimit me nr. 20230809/23300/1 është pajisur me autorizime për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas autorizimit nr. 44, datë 10/08/2023 dhe autorizimit me nr. 23979/1, datë 09.09.2023.*

Nga auditimi i të dhënave në data base kombëtar operatori ka importuar makineri me kod shtesë IP0, kodi i procedurës të zgjeruar “4000”, autorizim “Për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar”, DAV-et imp. 4 sipas tabelës të mëposhtme :

Manifattura Italiana II _ Nipt M36801201H								Procedura 4000 Kodi shtese IP0			
Autorizimi	Datë	DAV-i	Tip	NO	HS4	NK8	Përshkrimi	P. Net	Vlera euro	Vlera lekë	TVSH
nr.44	10-08-2023	11616	IM	4	8452	84522900	makineri per qepjen e konfeksioneve	925	8,025	846,106	169,221
nr.23979/1	09-09-2023	12538	IM	4	8452	84522900	makineri per qepjen e konfex me pa	822	6,420	699,954	139,991
	09-09-2023	12538	IM	4	8451	84513000	makineri hekurose dhe paisjet e sa	100	2,850	310,728	62,146
nr.23979/1	09-09-2023	12539	IM	4	8452	84522900	makineri per qepjen e konfex me pa	73	2,200	245,637	49,127
Totali								1,920	19,495	2,102,425	420,485

Referuar të dhënave nga data base kombëtare, konstatohet se operatori “Manifattura Italiana II” nuk ka kryer aktivitet ekonomik nën kushtet e RPA deri në periudhën e auditimit, duke mos dhënë një siguri të arsyeshme për ekzistencën e nevojës ekonomike për të cilin janë lëshuar autorizimet. Konstatimi që operatori ekonomik gjatë periudhës nuk ka kryer asnjë procedurë doganore në funksion të të cilit janë importuar edhe makineritë me përjashtim të detyrimeve doganore dhe njëkohësisht nuk ka njoftuar autoritet doganore mbikqyrëse për ndryshim të rrethanave ekonomike të tij, vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 28/2 të Kodit Doganor....

Dogana Vlorë të kryejë verifikimet në ambjentet e operatorit ekonomik “Manifattura Italiana II” Shpk me NIPT M36801201H për ekzistencën e makinerive dhe statusin e aktivitetit të këtyre operatorëve ekonomik.

- Nëse këto makineri gjenden në ambjentet dhe operatori është në procesin e kryerjes të planit të investimit të mbikqyrë në vijimësi këto autorizime.
- Nëse këto makineri nuk gjenden në ambjentet e operatorit, të procedojë në konstatim dhe vendimmarrje në mbështetje të kërkesave të neneve 250 pika 1/a dhe pika 4, 253/b/c, 258/1/a, të ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, duke llogaritur detyrimet doganore dhe penalitetet përkatëse të parashikuara nga këto dispozita.

Nga kontrolli i kryer, rezulton se operatori ekonomik “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H ka importuar makineri me kod Shtesë IP0, Regjimi 4000, me anë të autorizimit nr.44, me nr.23384/1 Prot., dt. 10.08.2023, “Për Përjashtim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar” dhe autorizimit nr.48, me nr.23979/1 Prot., dt. 08.09.2023, “Për Përjashtim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar”.

Autorizimi nr.74 datë 4.12.2020 për importimin e makinerive të mësipërme është lëshuar në bazë të Ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin e Vlerës së Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 56, pika 38, V.K.M nr. 953 dt., 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014” neni 8.

Referuar nenit nr.8, pika 2, të V.K.M nr.953/2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014”, përcaktohet shprehimisht se “Importimi i makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importuesi është vetë personi i tatueshëm që realizon investimin ose përdor makinerinë ose pajisjen, pra operatori ekonomik “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H është personi i vetëm që përdor makineritë e importuara me përjashtim nga pagesa e TVSH-së në import.

Në nenin 158 pika 2 të ligjit 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shprehimisht se: *“Administrata doganore ka përgjegjësinë për të vlersuar, ngarkuar, kërkuar dhe mbledhur TVSH-në në import, eksport dhe në lidhje me regjimet e tjera doganore, sipas këtij ligji”*. Neni 6 pika 20 të Ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet se *“Detyrim Importi” është detyrimi doganor që duhet paguar në Importimin e mallrave*.

Rezulton se nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, me email-in e datës 18/03/2025, ora 12:45, me lëndë “Informacion nga Dega Doganore Vlorë”, me të cilin ka parashtruar si vijon : *“Po ju kontaktojmë nga Dega Doganore Vlore. Prane subjektit "Manifattura Italiana II" me nipt M36801201H ishte planifikuar të kryhej kontrolli ditën e sotme në lidhje me makineritë e importuara me përjashtim nga TVSH. Grupi i punës, përfaqësues i Degës Doganore Vlore u paraqit ditën e sotme në adresën e deklaruar nga ana juaj në QKB, por në ambientet e deklaruar nga ana juaj, nga informacioni i siguruar nga ana jone na u komunikua se godina do të shembej dhe do të ndertohej një kompleks. Gjithashtu ju kontaktoam në numrin tuaj të telefonit por numri nuk ekziston. Ju lutemi të mërni masa për tu paraqitur pranë Degës Doganore Vlore për dhenien e destinacionit doganor makinerive të importuara me përjashtim nga TVSH, sepse në të kundërt nga ana jone do të meren masa administrative dhe penale në përputhje me legjislacionin doganor të Republikës së Shqipërisë”*.

Operatori “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H, i cili ka përfituar nga lehtësia fiskale e përjashtimit nga pagesa e TVSH në import, ka patur detyrimin ligjor të njoftojë autoritetin doganorë – Vlorë mbi çdo ndryshim në veprimtarinë e tij tregtare që lidhet me destinacionin e makinerive dhe pajisjeve të importuara me përjashtim nga pagesa e TVSH-së.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Bazuar në nenin 253 shkronja b dhe c të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” parashikon si kundërvajtje administrative të kryer me dashje, mos njoftimin e autoriteteve doganore nga operatori, konkretisht *“Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme nërrethina kundërvajtje të kryera me dashje: b) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit*

është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28; c) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit Fletore Zyrtare nr.134, datë 22 gusht 2014 6147 doganor, i detyrimit për të informuar autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor që lind pasi vendimi është marrë nga ato autoritete e që ndikon në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28.

Në nenin 258 pika 1 shkronja 'a' të ligjit 102/2014 dt., 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" citon se: "Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.

Referuar nenit 261 të këtij ligji, sanksionet e përcaktuar në nenet 256 deri në 259 zbatohen edhe në rastet e kontroleve pas çlirimit të mallrave (aposteriori). Në mbështetje të kërkesave të nenit 250 pika 1/a dhe pika 4, neni 253/b/c, neni 258/1/a dhe nenit 261 të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", operatori ekonomik "MANIFATTURA ITALIANA II" sh.p.k me NUIS M36801201H i llogariten penaltetet në masën e 3 – fishit të detyrimeve doganore në import.

Më tej, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbal i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032749, datë 27/03/2025, me Nr.1023 Prot., datë 04/04/2025, në të cilin është parashtruar si vijon : "Subjekti "MANIFATTURA ITALIANA II" që vepron nën RPA me autorizimin Nr.23300/1 dt 09.08.2023, është pajisur me autorizime përjashtime nga TVSH për makineri sipas autorizimit Nr.44 dt 10/08/2023 dhe autorizimit nr.23979/1 dt 09.09.2023. Nga kontrolli i kryer në ambientet e operatorit. Pra, operatori ekonomik nuk ka njoftuar autoritetet doganore në momentin e lëvizjes së makinerive nga adresa e deklaruar nga ai".

Proces verbal i lartcituar, i është njoftuar subjektit me shkresën nr.1023/1 Prot., datë 04/04/2025, me lëndë "Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative", si dhe me email-in e datës 10/04/2025, ora 03:08 AM.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

V E N D O S A :

- Subjekti “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H, me seli në Vlorë, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 420,485 (Katërqind e njëzetëmijë e katërqind e tetëdhjet e pesë) lekë.
- Subjekti “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H të penalizohet në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 1,261,455 (Njëmilion e dyqind e gjashtëdhjet e njëmijë e katërqind e pesëdhjet e pesë) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “MANIFATTURA ITALIANA II” sh.p.k me NUIS M36801201H, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj

